

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E HËNË 3 TETOR 2022

Tani të dalësh këtu e të flasësh, të them të drejtën, në një situatë ku jemi ne, çdokush prej deputetëve do të thotë: nga t'ia nis e nga t'ia bitis?! Pse?! Është e vështirë, sepse këtu për çdo gjë mund të flasësh jo me minuta, por do të duhen orë e ditë të tëra, sepse batërdia sundon në çdo aspekt, kudo. Unë dua të merrem me një çështje, që është mjaft problematike në zonën time, pra me çështjen e arsimit. Pse është problematike?! Sepse shpopullimi, si strategjia kryesore e kësaj qeverie, ka bërë që sot në të gjithë Shqipërinë të jenë të mbyllura 600 shkolla. Sot 50 mijë nxënës janë duke i zhvilluar mësimet në klasa kolektive.

Kjo situatë nuk është parë kurrë ndonjëherë, qëkur janë ndërtuar shkollat e para shqipe në këtë vend, që quhet Shqipëri. Kjo është një nga "dhuratat" më të mëdha, që u jep nxënësve qeveria e Edi Ramës, ose banda e Edi Ramës. Pra, edhe në zonën, ku unë jam deputet (kam edhe zonjën këtu mbrapa që është deputete, por sapo që dëgjoji se po flitet për zonën e saj, iku me vrap, kështu që përgjithësisht është hazër xhevapi, jo ti, është ajo zonja tjetër, kur vjen puna për të bërë ndonjë gallatë, por, kur vjen puna për hallet, ia fut vrapit, ikën), është problematikë e madhe çështja e arsimit. Ashtu siç e dini ju, kanë kaluar 3 vjet nga tërmeti. E mbani mend?!

U tha me të madhe se kanë një plan, i cili do të rindërtonte, pra plani i rindërtimit, por asnjë shkollë as në Vorë, as në Kamzë, as në Paskuqan dhe as në Zall-Herr në këta 3 vjet nuk është ndërtuar. Nxënësit kanë qenë me 2 turne dhe tani, pas 3 vjetësh, qeveria e Elisës dhe e Edi Ramës i kanë kthyer me 3 turne. Mirë që i kanë bërë me 3 turne, por çfarë kanë bërë?! Shumica e nxënësve udhëtojnë vetë, e zgjidhin privatisht udhëtimin. Flitet për një zonë, që është shumë e varfër, për një zonë, ku 60% e popullsisë jetojnë me ndihmë ekonomike. Mendoni një banor i ka kësaj zone në Kamzë me ndihmë ekonomike 40 mijë lekë duhet të paguajë 30 mijë lekë privatisht fugin dhe mjetet e tjera për ta çuar fëmijën në shkollë.

Kjo qeveri atij hallexhiut i jep mundësi të ketë vetëm 10 mijë lekë të vjetër për të paguar dritat, ujin, bukën, veshmbathjet dhe të gjitha gjërat. Pra, kjo është qeveria! Ky është peizazhi! Çfarë

kanë bërë tjetër? Kishte 3 vjet që këto 8 shkolla nuk ishin as të evidentuara si të dëmtuara nga tërmeti, as me krisje, as me probleme, me asnjë gjë, por tani, pas 3 vjetësh, kujtohen dhe i prishin. Ishte shkolla “Demokracia”. U kujtuan për të vjedhur ndonjë lekë, për të bërë tenderë dhe vendosën që shkolla “Demokracia” të priset, të shkatërrohet. Ajo ishte e padëmtuar nga tërmeti dhe ishte ndërtuar para pak vjetësh.

Këto ishin shkolla të ndërtuara nga Banka Botërore, nga BERZH-i, nga qeveritë e mëparshme, sigurisht, nga qeveria e Partisë Demokratike. Jo, ato do të prisheshin. Çfarë ndodhi?! U prish shkolla “Demokracia”; u prish shkolla “Gramoz Palushi” në Paskuqan; u prish shkolla “Azem Hajdari” në Paskuqan; u prishën shkollat “Azem Hajdari dhe “Sulejman Elezi” në Kamzë; u prish shkolla “Ibrahim Basha” në Bathore; u prish shkolla “Hilari Klinton” në Kamzë dhe u çuan të gjithë në shkolla të tjera. Çfarë po ndodh?! Po pse ndodhi kjo? Kjo ndodh, sepse këta nuk njohin limit në babëzi. Shkollat i bëjnë për të bërë tenderë.

Një tender për një shkollë, që ndërtohet nga UNDP-ja apo FSHZHja, kap shifrën 680 apo 700 mijë euro, ndërsa këta i kanë filluar shkollat me 2 milionë euro minimumi, pastaj shkojnë deri në 4,7 apo 5,7 milionë euro. Ja, pra, pa pasur lidhje me tërmetin, vetëm për të vjedhur tenderë sot po masakrohen nxënësit dhe familjet, por askush nuk bën zë. Kjo zonja këtu, që ka qejf të kakarisë dhe të bilbilosë sa herë që flet opozita, zhduket kur vjen çështja që po diskutojmë. Kjo është fytyra e këtij regjimi. Ky është prioriteti kur flasin këta për arsimin. Në këtë pikë dhe në këtë derexhe e ka çuar kjo bandë arsimin në Shqipëri, më pas vijnë këtu e na tregojnë për arsimin, për turizmin, për përrallat dhe për dokrrat, por ky është realiteti. Faleminderit!